



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo za Obrazovanje i Nauku /
Ministry of Education and Science

Ministria e Arsimit dhe Shkencës duke u bazuar në Vendimin të Ministrit nr. 01-1676
të datës 22.07.2020:

SHPALL
KONKURS

PËR NDARJE TË 40 BURSIVE PËR FEMRA PËR REGJISTRIM NË DREJTIME TEKNIKE NË
INSTITUCIONE TË ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2020-
2021

Realizimi i të drejtës për bursë për drejtime teknike

Të gjitha femrat të cilat përfundojnë shkollimin e mesëm të ulët, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuar në konkurs kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet teknike në të gjitha IAAP-të në Republikën e Kosovë të cilat ofrojnë një nga profilet në vijim:

- 1. Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit;**
- 2. Instalues elektrik;**
- 3. Mekatronikë; dhe**
- 4. Automekanik.**

Kushtet dhe kriteret

- Për fitimin e bursës së MASH, kandidatet duhet ti plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
 - 1.1. Të jenë shtetase të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Suksesi i shkollimit paraprak – klasat 6 – 9.

Dokumentacioni që kërkohet për aplikueset:

- Kërkesë për bursë, duke cekur edhe drejtimin për të cilin aplikon;
- Certifikatën e shkollës së mesme të ulët;
- Suksesi për klasat 6 - 9;
- Certifikatën e lindjes.

Procedurat e aplikimit

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në IAAP;
- Drejtorët e IAAP-ve i dorëzojnë aplikacionet në MASH më 28 Gusht 2020;
- Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Konkursi do të jetë i hapur prej 17 deri 27 Gusht 2020.

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej 3 (tri) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASH, kati përdhës, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga Komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASH.